



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-26186/24 datë:23.09.2024



Npi – 01/315 datë: 30.09.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 30.09.2024, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IX- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 30.09.2024 (e hënë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: znj.Vlora Hyseni dhe Albion Shabani nga zyra për Informim. Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 27.08.2024,
2. Plani-Buxhetor i Komunës së Shtimes për vitin 2025 (pas diskutimit publik),
3. Propozim - Vendim për fshirjen e obligimeve Tatimore të AKP-së ndaj Komunës së Shtimes,
4. Propozim - Vendim për miratimin e shkallës tatimore progresive për vitin 2025,
5. Propozim-Vendim për ndarjen e parcelës për objektet e banimit të përbalueshëm dhe social,
6. Informatë nga DSHP-ja lidhur me përgatitjet dimërore, dhe menaxhimin e mbeturinave, dhe furnizimin me ujë,
7. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës. Në vazhdim, Konstatoj Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, unë mendoj se nuk duhet me u diskutu fare disa pika që tash më veq janë miratuar në Kuvend, siç janë pikat e rendit të ditës 2, 3, 4, dhe 5 kështu që mbetet për tu diskutuar vetëm pika 1, pika 6 dhe pika 7. Meqenëse këto pikat tjera kanë kaluar në Kuvend tani nuk mendoj se duhet me u diskutu në Komitet.

znj.Rrezartë Ramdani; Përshëndetje, edhe unë jamë për ta diskutuar vetëm pikën 1 Procesverbali dhe pika 7 Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Parimisht keni të drejtë, dhe e dimë që këto pika kanë kaluar në Kuvend por ndoshta mundemi me i diskutuar këto pika, ndoshta Idajeti mundet me na ndihmuar pak.

z.Idajet Rexhepi, zyrtar i Kuvendit; Përshëndetje, siç e dini edhe u tha këtu disa herë se pikat 2 deri në 5 kanë kaluar në Kuvend, mendoj se është e pa dobishme tani të diskutohet për këto pika, sepse ka kaluar koha kur Komiteti ka mujt me paraqitë ndonjë rekomandim për Kuvendin.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Atëherë pra po i qes në votim pikat 1, 6 dhe 7 kush është për miratimin e këtijë rendi të ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 27.08.2024,
2. Informatë nga DSHP-ja lidhur me përgatitjet dimërore, dhe menaxhimin e mbeturinave, dhe furnizimin me ujë,
3. Të ndryshme.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 27.08.2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 27.08.2024.**

Pika 2

Informatë nga DSHP-ja lidhur me përgatitjet dimërore, dhe menaxhimin e mbeturinave, dhe furnizimin me ujë

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi: Unë e kam marrë informatën nga DSHP-ja dhe e kam lexuar. Ne kemi diskutuar në Kuvend dhe kemi pas disa pyetje dhe disa vërejtje. Unë po besoj se edhe ju e keni marrë informatën. Në vazhdim e lexoi informatën në pikat kryesore nga telefoni mobil, (shih informatën). Unë në Kuvend e kam ngritur çështjen e therjes së kafshëve në hapsirat publike me ç'rast edhe po ndotet ambienti por edhe po grumbullohen qenët endacak, dhe po paraqesin rrezik për kalimtarët. Poashtu kam diskutuar edhe për mirëmbajtjen e parqeve, trotuareve sepse po ka munges të mirëmbajtjes së tyre.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Faleminderit Besnik, nuk e di sa është diskutuar çështja e furnizimit me dru për dimër për familjet nevojtare. Unë e kam vërejtur edhe një çështje që po dua ta ngris, e ajo është se e kam pa që uji i ujësjellësit në fshatrat e rrafshit, sidomos në Gjyrkovc po kontaminohet, dyshimet janë se po bëhet përzirja e ujit të puseve private me ujin e ujësjellësit. Unë propozoj që Drejtoria për Shërbime Publike me qu inspektoratin për me i kontrollu lidhjet e konsumatorëve në ujësjellës, ku uji i puseve po kthehet mbrapa në gypat e ujësjellësit dhe uji po kontaminohet. Pastaj duhet të kontrollohet edhe pagesa që bëhet për ujësjellës sepse edhe pagesa ndikon në kualitetin e ujit.

znj.Rrezartë Ramadani; E përkrahu propozimin e Kryesuesit për me i kontrollu lidhjet në ujësjellës, te ne në Shtime tash së fundi kanë qenë inspektorat dhe e kanë kontrolluar furnizimin me ujë për pije.

z.Besnik Seferi: Mendoj se është mirë që ne si Komitet me bërë një rekomandim për këtë çështje në Drejtorinë për Shërbime Publike.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, unë çështjen e furnizimit me ujë të lagjes tonë “Eqrem Qabej” e kam ngritur disa herë por nuk ka pas sukses, arsyet nuk i di por ne kemi bërë përpjekje që këtë problem me e zgjedhë përmes hapjes së puseve private në atë legje. Gypat e ujit janë por ujë nuk kemi asnjëher, dhe problemi është edhe më i madh sepse mua më është fakturuar si shpenzim i ujit 300 euro dhe e kam kryer pagesën. Mund të them me përgjegjësi se në rrugën “Eqrem Qabej” që lidhet me rrugën “Anton Çeta”, ujë për pije nuk ka as në dimër e as në verë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Konstatoi Kuorumin prej 6 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -XI- për vitin 2024, të mbajtur më: 30.09.2024, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi, Drejtorisë për Shërbime Publike që ta adresojë dhe të merr masat e nevojshme për sa i përket përzirjes së ujit të pijes me ujin e sistemit të ujësjellësit në fshatrat e rrafshit. Ezistojnë dyshime të bazuara se uji i ujësjellësit po përzihet me ujin nga pusët e ujit të banorëve, me theks në fshatin Gjyrkovc. Po ashtu Komiteti kërkon nga Drejtoria për Shërbime Publike që të shikojë mundësinë e furnizimit me ujë të pijes edhe lagjen “Eqrem Qabej” në Shtime.**

Pika 3

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Desha ta ngris çështjen e furnizimit me dru për ngrohje për sezonin e dimërit, për familjet në novojë. Mendoj se është e nevojshme që tu ndihmojmë sa do pak këtyre familjeve për ta kaluar dimrin me një sasi të sigurimit të druve për ngrohje.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, propozoj ne anëtarët e Komitetit në muajin tetor të bëjmë disa vizita nëpër shkolla, që ka të bëjë me suksesin dhe vijueshmërinë e tyre, të shohim se a janë paisur të gjithë me tekstet mësimore, dhe po ashtu të shohim nga afër edhe fenomenin e braktisjes së shkollave. Unë e kam vërejtur një rast në fshatin Muzeqinë, ku një vajzë 15 vjeçare e ka braktisur shkollën, tash po jetojke në Fushë Kosovë, dhe për fat të keq, prindërit i kishte shurdhë-memecë.

z.Besnik Seferi; Unë mendoj se këtu nuk ka nevojë për rekomandim për sa i përket ndihmave me dru për ngrohje, sepse Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e kanë planin e vetë për këtë çështje, dhe unë kam biseduar me drejtoreshën për këtë çështje, dhe ajo më ka thënë se janë duke punuar në këtë drejtim.

z.Muhamet Mehmeti; Pajtohem me Besnikun, sepse drejtoresha e ka listën e nevojtarëve. Mirëpo konsideroj se një çështje tjetër është e rëndësishme të diskutojmë se çka me ba me ato raste që vërtetë kanë nevoj për këtë ndihmë, mirëpo nuk janë përfitues të skemave sociale, qysh mundemi me ju ndihmuar këtyre rasteve?

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Edhe unë pajtohem me Besnikun por edhe me Muhametin, por më bëri përshtypje, për rastet e familjeve që nuk janë në asistencë sociale se si mundemi me ju ndihmuar. Unë po e tërhjeki propozimin, sepse po e bëjmë si pikë për mbledhjen e radhës.

z.Besnik Seferi; Pra po kërkojmë një informatë konkrete lidhur me këtë çështje për Komitetin, e jo informatë të përgjithësuar, dhe tek pastaj kemi mundësi për me bërë ndonjë rekomandim.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Vizitat në shkolla po i lëmë në fillim të javës së ardhëshme saktësisht po e lëmë më datën 07.10.2024 e hënë. Pasi që diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 15:03h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

